

Shkurt

- Futja e lejes së re të qëndrimit në 1 shtator 2011
- Ajo zëvendëson tallonat ngjitëse të mëparshme
- Standardizim i lejes së qëndrimit për rezidentë nga vendet jo anëtare të BE-së në Evropë
- Format karte krediti
- Brenda kartës çipi që mundëson identifikim pa e prekur kartën
- Mbrojtje nga keqpërdorimet përmes fotografisë dixhitale dhe shenjave të gishtave, duke mundësuar kështu identifikimin e saktë të lejes dhe mbartësit të saj.
- Funksion identifikimi elektronik për transaksionet në internet dhe nëpër distributorë.
- E përgatitur për firmosje elektronike për dokumentet me detyrim ligjor për firmosjen dixhitale.



Leja elektronike e qëndrimit (eAT)

Leja e zakonshme e qëndrimit (tallonin ngjitës), karta e qëndrimit dhe karta e lejes së përhershme të qëndrimit dhe letërnjoftimi i rinovueshëm prej letre do të zëvendësohen duke filluar që nga 1 shtator 2011 me një leje qëndrimi elektronike (elektronischer Aufenthaltstitel – eAT) që do t'i ngjajë një karte krediti.

Leje elektronike e qëndrimit është e pajisur me një çip brenda saj që lejon identifikim pa qenë e nevojshme që ta prekësh ose ta nxjerrësh kartën nga xhepi, në të cilin janë regjistruar të dhëna biometrike (fotografia dhe gjurmët e dy gishtave), të dhëna të tjera shtesë (kushte të veçanta) si dhe të dhëna personale. Çipi gjithashtu është në gjendje që të përdorë dokument identiteti elektronik si dhe një firmë të vërtetuar elektronike.

Të gjitha vendet e BE-së kanë duhet të fusin sistemin e lejeve elektronike të qëndrimit. Kjo bazohet në Rregulloren e BE-së Nr. 1030/2002 dhe atë Nr. 380/2008. Synimi është që të standardizohet sistemi i lejeve të qëndrimit në Bashkimin Evropian, të përforcohen lidhjet midis dokumentit dhe mbartësit të dokumentit si dhe të parandalohen keqpërdorimet e dokumenteve falë të dhënave biometrike. Të gjithë rezidentët nga vendet jo anëtarë të BE-së (duke përfshirë foshnjat dhe fëmijët) do mbartin lejet e tyre të veçanta të qëndrimit.

SHËNIM

Lejet e mëparshme të qëndrimit nëpër pasaporta dhe dokumente që zëvendësonin pasaportat do të ngelen të vlefshme deri në 30 prill të 2021-shit.

Siguria e të dhënave

Të gjitha informacionet dhe miratimet ruhen me metoda të njohura dhe të afirmuara botërore kodimi. Një certifikatë autorizimi përcakton se kush lejohet të ketë akses në të dhënat lidhur me personin. Mbartësit e dokumenteve kanë garancinë se vetëm zyra të autorizuar do t'u lejohet të kenë akses në këto të dhëna.

Karakteristikat biometrike

Fotografia regjistrohet mbi kartë dhe tek çipi në brendësi të saj. Në çip do të regjistrohen gjithashtu edhe gjurmët e dy gishtave për gjithë rezidentët që vijnë nga vendet jo anëtarë të BE-së, nga mosha 6 vjeç e sipër.

Për këtë arsye kur aplikohet për kartën e qëndrimit duhet shkuar personalisht.

Vetëm zyrtarët (si policët, autoritetet e emigracionit dhe zyrtarët e gjendjes civile) janë të autorizuar të kenë akses tek fotografitë dhe gjurmët e gishtave.

Masa të tjera (kushte të veçanta)

Marrëdhënie varësie regjistrohen në çip dhe te një fletë e veçantë shtesë që është e bashkëngjitur me lejen elektronike të qëndrimit.

Tek karta është shkruar shënimi "SHIH FAQEN SHITESË". Nëse të dhënat e tjera shtesë ndryshojnë do të mbushet një faqe e re shtesë dhe të dhënat tek çipi do të ndryshohen.

Vetëm entet zyrtare kanë akses tek të dhënat e tjera shtesë.

Funksioni i identifikimit online

Entet e fushës së ekonomisë dhe financës (si p.sh. bankat ose autoritete zyrtare) do të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime elektronike ku mbartësi i dokumentit do të identifikohet në mënyrë elektronike duke përdorur lejen elektronike të qëndrimit. Kjo lehtëson procesin e hyrjes me të dhënat vetjake në portale interneti, mbushjen e formularëve dhe verifikimin e moshës së vet në internet apo në distributorë.

Vetëm entet që kanë autorizim shtetëror do të kenë akses në të dhënat e mbartësit të kartës. Nga ana tjetër, mbartësi i dokumentit duhet të konfirmojë transferimin e të dhënave të saj ose të tij me një numër pin me gjashtë shifra.

Dhënësit e shërbimeve nuk janë në gjendje që të lexojnë të dhënat biometrike gjatë përdorimit të funksionit të identifikimit online.

Funksioni i firmosjes

Leja elektronike e qëndrimit mund të mbartë të regjistruar në të një certifikatë për firmosjen e vërtetuar elektronike. Kjo i jep mundësinë mbartësit të lejes elektronike të qëndrimit që të firmosin ligjërisht dokumente dixhitale sipas dëshirës.

Botuesi:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge
(Zyra Federale për Emigracionin dhe Refugjatët)